



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.48/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti-kryesues, Bujar Muzaqi dhe Skender Çoçaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Duda Balje, nga subjekti politik Social Demokratska Unija (SDU), me seli në Prizren, të paraqitur kundër Emilija Redzepi nga subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Prizren, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më 23.09.2025, merr këtë,

**V E N D I M**

I. Pranohet si e bazuar ankesa e Duda Baljes, nga subjekti politik Social Demokratska Unija (SDU), me seli në Prizren, ZL.Anr.48/2025 e datës 20.09.2025.

II. Subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Prizren, me kryetare Emilija Redzepi, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 3000.00 euro, (tremijë euro).

III. Detyrohet Subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Prizren, me kryetare Emilija Redzepi, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

**A r s y e t i m**

Me datën 20.09.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesën e identifikuar me numër ZL.Anr.48/2025, nga Duda Balje, nga subjekti politik SDU, me seli në Prizren, me te cilën pretendon se më datën 19.09.2025, gjatë debatit në shërbimin publik RTK 4, Emilija Redzepi më ka ofenduar publikisht dhe me vetëdije mua, Duda Balje, konkretisht, ajo e ka mohuar hapur përkatësinë time kombëtare, duke pretenduar se unë nuk jam boshnjake, por gorane. Me këtë ajo ka fyer jo vetëm mua personalisht, por edhe tërë komunitetin boshnjak në Republikën e Kosovës, duke vënë në pikëpyetje identitetin, barazinë dhe ekzistencën politike të tij. Është e rëndësishme të theksohet se znj. Redzepi ka vazhduar me ofendime edhe pasi moderatorja e debatit e ka paralajmëruar të ndalet. Një sjellje e tillë nuk është incident, por qëndrim i saj diskriminues dhe poshtërues ndaj komunitetit boshnjak.

Në përgjigje në ankesë pranuesi i ankesës gjegjësisht znj. Redzepi ka deklaruar se në lidhje me ngjarjet gjatë debatit të mbajtur më 19.09.2025 në shërbimin publik RTK, thekson se zonja Balje nuk ishte e pranishme në debatin e përmendur, as nuk mori pjesë në diskutim. Prandaj,

ajo nuk mund të ketë qenë e ekspozuar ndaj fyerjeve personale apo sulmeve verbale siç pohon në ankese. Thekson veçanërisht se është e pavërtetë që ajo gjatë debatit të ketë dhënë ndonjë paralajmërim ose të ketë kërkuar ndonjë falje nga ana ime, pasi që ajo fizikisht nuk ishte e pranishme në ngjarje. Rreth deklaratave të dhëna gjatë debatit që zonja Balje është gorane nuk ishte një fyerje. Pohimet se e kam vënë atë në një kontekst të padrejtë ose e kam etiketuar si Gorane në mënyrë përbuzëse, janë të pasakta dhe krejtësisht të paargumentuara. I komentoj këto pohime si të pavërteta dhe të padrejta dhe i refuzoj qartë. Nuk ka qenë fyerje, por një referencë e kontekstualizuar politikisht në rajonin nga vjen ajo, dhe ku vazhdimisht realizon mbështetjen më të madhe nga votuesit. Është e rëndësishme të theksohet se deklarata e përmendur u dhënë brenda diskutimit mbi decentralizimin dhe ishte e drejtuar ekskluzivisht në kontekstin rajonal dhe politik. Deklarata ime është plotësisht në përputhje me deklaratat e saj publike mbi identitetin e saj personal, duke përfshirë edhe një paraqitje në një mbledhje në Maqedoninë e Veriut gjatë fushatës elektorale në Shoqatën e Goranëve në Shkup, për zgjedhjet qendrore, ku ajo thotë se e la partinë DSB (Koalicija Vakati) për arsye se ata e fyerin prejardhjen e saj gorane, për të cilën ajo është krenare. Rreth rëndësisë së identitetit goran, komuniteti goran është një kategori kushtetuese, dhe të jesh me prejardhje gorane apo nga çdo prejardhje tjetër është diçka krenare, e ndershme dhe e sigurtë. Unë nuk shoh asnjë arsye pse dikush duhet të ofendohet apo të turpërohet për prejardhjen e tij, sidomos kur ajo theksohet publikisht dhe me krenari në paraqitjet publike dhe fushatat e zonjës Balje.

4. Materialet provuese. Si konfirmim të deklaratave të mia, paraqes sa vijon: një regjistrim të promovimit publik nga shkurti 2025, ku zonja Balje vetë theksoi se është me prejardhje nga Gora. <https://www.facebook.com/share/v/1MJu5grDB9/>, Foto dhe postime publike të disponueshme në profilin e saj në rrjetet sociale, ku ajo promovon veten me veshje tradicionale gorane. E njëjta thekson se deklaratat e mia nuk kanë karakter fyes, diskriminues apo përçmues, dhe konsideron se ankesa e parashtruar është e pabazuar dhe e paargumentuar, pasi që qëllimi im ishte vetëm të theksoja prejardhjen politike dhe rajonale brenda debatit publik ku tema ishte decentralizimi, në përputhje me deklaratat publike të zonjës Balje vetë, pa asnjë konotacion fyes. Propozon që ankesa të refuzohet në tërësi.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën, përgjigjen në ankesë, dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, dhe vëren se ankesa e ankueses është e bazuar.

Paneli, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të ofruara si provë materiale në ankesë-incizimit të debatit televiziv në CD, të cilat janë ofruar nga Social Demokratska Unija (SDU), me seli në Prizren, vëren se kryetarja e subjektit politik, Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Prizren, në Televizioni Publik RTK 4 më datë 19.09.2025, në debatin televiziv ka përdorur shprehjet, “*ju e keni kryetaren Gorane ajo është përfaqësuese e komunitetit Goran*”, fakt ky i pranuar nga Nova Demokratska Stranka (NDS) përkatësisht, Emilijja Redzepe, në përgjigjen në ankesë të datë 21.09.2025, e cila deklaroi se “*Deklarata ime është plotësisht në përputhje me deklaratat e saj publike mbi identitetin e saj personal, duke përfshirë edhe një paraqitje në një mbledhje në Maqedoninë e Veriut gjatë fushatës elektorale në Shoqatën e Goranëve në Shkup, për zgjedhjet qendrore, ku ajo thotë se e la partinë DSB Koalicija Vakati për arsye se ata e fyerin prejardhjen e saj gorane, për të cilën ajo është krenare.*” vlerëson se e njëjta është e bazuar, sepse përdorimi i një gjuhe të tillë është në kundërshtim me nenin 34 paragrafi 1, pika 1.11, të LZP-së, me të cilën përcaktohet, “*Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik,*

*mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”.* Prandaj për Panelin nga incizimi i debatit rezultoi se znj. Rexhepi ka bërë deklaratë të drejtpërdrejta mbi përkatësinë etnike të ankueses, duke mohuar identitetin e saj të deklaruar si përfaqësuese e Komunitetit Boshnjak në KQZ, sipas regjistrimit të subjekteve Politike në KQZ, pjesëmarrëse në zgjedhjet lokale, ku Dude Balje figuron si kryetare e subjektit politik, Social Demokratska Unija (SDU), me çka edhe është certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhje. Paneli vlerëson se një deklaratë e tillë në kontekstin zgjedhor dhe të ndjeshmërisë etnike në Republikën e Kosovës, mund të ndikojë negativisht në perceptimin në publik të kandidatës dhe komunitetit të përfaqësuar. Po ashtu paneli pas dëgjimit të CD-së verën se e njëjta ka vazhduar me komentet edhe pasi që ishte paralajmëruar nga moderatorja e programit për gjuhën e përdorur, gjë që dëshmon për qëllim të vazhdueshëm nënçmues e jo për deklaratë të rastësishme, po ashtu sipas panelit deklarata të tilla përbëjnë shkelje të fushatës së ndershme, siç përcaktohet me nenin 34. paragrafi 1 pika 11, e të cilat cenojnë barazinë e pjesëmarrësve në zgjedhje.

Sipas vlerësimit të panelit pavarësisht nga deklarata e dhënë në Maqedoninë e Veriut gjatë fushatës elektorale në Shoqatën e Goraneve në Shkup nga Dude Balje për identitetin personal, kjo nuk legjitimon përdorimin e gjuhës së tillë marrë për bazë faktin se Dude Balje është kryetare e subjektit politik që është e certifikuar në KQZ si parti që i mbron interesat e komunitetit Boshnjakë në Republikën e Kosovës.

Sipas Panelit, Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politike të jenë në një atmosferë të tolerancës demokratike, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Prandaj, Paneli vëren se gjuha e përdorur nga Nova Demokratska Stranka (NDS) përkatësisht, Emilija Redzeqi, është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, ku janë të përcaktuara veprimet e ndaluara të subjekteve politike përkatësisht, neni 34 paragrafi 1, pika 1.11, të LZP-së, prandaj, për panelin një veprim i tillë është në kundërshtim me dispozitat e sipërcituara,

Në këtë rast është marrë për bazë konteksti dhe qëllimi për të cilin është dhënë deklarata në Televizioni publik TRK 4, prandaj, sipas Panelit, përdorimi i gjuhës së tillë ka për qëllim nxitje të urrejtjes gjatë fushatës zgjedhore. Sipas vlerësimit të Panelit, rregullat që rregullojnë fushatën zgjedhore kërkojnë nga subjektet politike dhe përfaqësuesit e tyre të shmangin përdorimin e gjuhës fyese, denigruese dhe urrejtëse. Përdorimi i kësaj gjuhe nga Nova Demokratska Stranka (NDS), sipas Panelit është shkelje e etikës zgjedhore dhe standardeve të sjelljes në fushatë zgjedhore. Sjellja e tillë minon procesin demokratik dhe promovimin e zgjedhjeve të lira e të drejta. Fushatat zgjedhore duhet të zhvillohen në një ambient të ndershëm dhe të drejtë, duke respektuar të drejtat dhe dinjitetin e të gjithë qytetarëve dhe grupeve shoqërore. Shprehjet që janë përdorur mund të krijojnë një atmosferë të pasigurt, duke shkelur

kështu parimet e një fushate pozitive dhe të respektit ndërmjet subjekteve pjesëmarrëse në zgjedhje.

PZAP-i me rastin e shqiptimit të gjobës ka marrë për bazë kontekstin se deklarata është bërë në kohën e fushatës zgjedhore dhe se nxit urrejtje politike.

Paneli, me rastin e vendosjes së lartësisë së dënimit si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 34 pika l.11), nenit 118 paragraf 1 dhe nenit 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës  
ZL.Anr.48/2025 datë 23.09.2025

Kryesues i Panelit  
Hajriz Hoti



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së.